

Çfarë është KPV (CAF)?

KPV (Kuadri i Përbashkët i Vlerësimit) është një sistem i menaxhimit të cilësisë për administratat publike, me të cilin punonjësit dhe menaxherët vlerësojnë organizatën e tyre, përcaktojnë fuqitë dhe potencialin e tyre për përmirësim dhe më pas bëjnë përmirësime. KPV është i përshtatshëm si një sistem i vlerësimit të cilësisë për administratat publike në nivel evropian, kombëtar, rajonal dhe vendor. KPV mund të përdoret për të gjithë organizatën ose për departamentet e përzgjedhura.

Faktet më të rëndësishme rreth KPV (CAF):

- ✓ KPV është menaxhimi i cilësisë!
- ✓ KPV është vetëvlerësim nga anëtarët e organizatës!
- ✓ KPV ka nevojë për ekipet e vetëvlerësimit!
- ✓ KPV është një pyetësor me 200 pyetje!
- ✓ KPV do të thotë konsensus!
- ✓ KPV është një udhëzues për menaxhimin dhe qeverisjen publike!
- ✓ KPV - është mjet vetëvlerësimi për identifikimin e fushave për përmirësim!
- ✓ KPV është hulumtim dhe përcaktim i parametrave cilësor (Benchlearning)!

Grafiku i modelit të KPV (CAF)

Mundësuessit			Rezultatet	
1. Drejtimi (udhëheqja)	3. Njerëzit	5. Proceset	7.Rezultatet për njerëzit	9.Rezultatet e performancës kyçe
	2. Strategjia & planifikimi		6.Rezultatet për qytetarët-klientët	
	4. Partneriteti & Burimet		8.Rezultatet në lidhje me përgjegjësinë shoqërore	

Pse duhet ta përdorim KPV (CAF)?

1. I përshtatur për nevojat e administratave publike:

KPV është një mjet i menaxhimit të cilësisë i zhvilluar nga administratat publike për administratat publike.

2. Përmirësimi i performancës së administratave publike

KPV identifikon pikat e forta dhe fushat për përmirësimin e organizatës, ndërsa në të njëjtën kohë është i ndjeshëm për përmirësime dhe masa për zhvillim të mëtejshëm.

3. Aplikimi i thjeshtë

KPV u krijua për t'u përdorur nga vetë administratat publike ose vetëm me pak mbështetje të jashtme.

4. Rezultate të shpejta dhe të qëndrueshme me kosto të ulët

Pyetësori i KPV mund të shkarkohet nga <https://www.respaweb.eu/caf>. Krahasuar me mjete të tjera të menaxhimit të cilësisë, rezultatet do të jenë në dispozicionin tuaj shumë shpejt.

5. Qëndrueshmëria

Vetëvlerësimi dhe menaxhimi i cilësisë me KPV janë fillimi i një procesi përmirësimi të vazhdueshëm në një organizatë. Rekomandohet përdorimi i rregullt i KPV (më e mira është çdo dy vjet).

6. Reagime të jashtme (feedback)

Me etiketën e KPV, mundësohen vlerësimi i thellë dhe konfirmimi nga reagimet e jashtme

7. Mësoni nëpërmjet krahasimeve dhe rrjeteve

KPV u zhvillua për të gjitha administratat publike në BE. Bazuar në rrjetin e KPV, përdoruesit e KPV mund t'i krahasojnë rezultatet e tyre me të tjerët dhe të mësojnë së bashku.

8. Përmirësimi i imazhit të administratave publike

KPV-ja ju çon drejt një organizate moderne, të orientuar nga qytetarët dhe efikase, që jeton në transparencë dhe pjesëmarrje, dhe, në këtë mënyrë, forcon legjitimitetin e administratave publike. Qytetarët, klientët, punonjësit si dhe politika e administrata përfitojnë nga një imazh më i mirë.

KPV – Shërbimet e Qendrës Rajonale për Cilësinë

Vizioni: ReSPA është një qendër rajonale inovative ndërqeveritare për kërkim në fushën e politikave, shkëmbimin e njohurive, bashkëpunimin rajonal dhe rrjetëzimin në fushën e administratës publike.

Misioni i ReSPA-s është të përmirësojë bashkëpunimin rajonal, të nxisë të mësuarit e përbashkët dhe të mbështesë zhvillimin e administratave publike në Ballkanin Perëndimor, dhe përmes kësaj, të mbështesë integrimin në BE.

Shërbimet tona:

Mbështetja e zbatimit të KPV

Qendra Rajonale e Menaxhimit të Cilësisë ReSPA (RQC) i shoqëron administratat publike dhe organizatat e lidhura me to në përgatitjen, zbatimin dhe ndjekjen e aplikacionit të KPV-së.

Elementet kryesore të shërbimeve të zbatimit janë:

1. Këshilla për përshtatjen e pyetësorit të KPV-së për nevojat individuale të organizatës – **seancë (workshop) e përshtatjes** - 1- ditore;
2. Trajnimi i ekipit të vetëvlerësimit të KPV-së – **seancë trajnimi** 1-ditore;

3. **Monitorimi i vazhdueshëm** i gjithë procesit të KPV-së;

4. Përgatitja dhe moderimi i **një seminari dy-ditor të vetëvlerësimit** për KPV-në;
Me më shumë se 150 punonjës pjesëmarrës, rekomandohet të zhvillohen seminare paralele të vlerësimit të KPV-së.

5. Dokumentimi i rezultateve të seminarit të vetë-vlerësimit për KPV-në, në një **raport të konsoliduar**;

6. Përgatitja dhe moderimi i seminarit 1-ditor të planit të veprimit të KPV-së.

Baza e njohurisë së KPV-së:

RQC ofron materiale, prezantime, udhëzime, video udhëzuese, dhe më shumë, për KPV-në, për organizatat e interesuara, drejtuesit dhe menaxherët e cilësisë së administratës publike. Në faqen tonë të internetit <https://www.respaweb.eu/caf> ju do të gjeni të gjithë materialin përkatës, si dhe informacionet tona të kontaktit.

Trajnimet për KPV-në:

Seminar themelor për të “sapoardhurit” në KPV

RQC ofron seminare themelore për të **“sapoardhurit” në KPV**. Seminari 1.5-ditor do të prezantojë bazat e menaxhimit të cilësisë dhe informacionin e sfondit për KPV-në dhe modelet e tjera të menaxhimit të cilësisë. Ushtrime praktike në proceset e simuluar të vetëvlerësimit përmbyllin seminarin.

Trajnimi i moderatorëve të KPV-së

RQC ofron trajnime të personalizuara për moderatorët e KPV-së. Në këto trajnime ju do të merrni të gjitha mjetet për të futur KPV-në në mënyrë të pavarur në organizatën tuaj dhe për të zbatuar me sukses procesin e ndryshimit.

Rrjeti & Baza e të Dhënave të KPV-së (CAF):

RQC përpiqet të ndërtojë një rrjet rajonal të KPV-së dhe të vërë në dispozicion të organizatave të tjera të interesuara praktikant më të mira të zbatimit të suksesshëm të KPV-së:

1. Të gjitha dokumentet e nevojshme të KPV-së (CAF) mund të gjenden në seksionin e CAF në faqen e ReSPA <https://www.respaweb.eu/10/caf>
2. Me bazën e të dhënave të CAF (KPV-së) detajet e kontaktit të përdoruesve të CAF-it grumbullohen me qëllimin e transferimit të njohurive.
3. RQC organizon takime të rregullta të rrjetit për të nxitur shkëmbimin e informacionit midis përdoruesve të CAF (KPV-së) dhe për të promovuar dhe zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme CAF si një mjet për menaxhimin e cilësisë.

Etiketa e KPV-së (CAF)

Etiketa e cilësisë e CAF-it, në shqip KPV-së, "Përdoruesi efektiv i CAF-it" është një reagim për CAF nga përdoruesit e jashtëm, përdorues të CAF me përvojë dhe/ose drejtuesit e cilësisë.

Organizatat e sektorit publik kanë shprehur dëshirën për të parë rezultatet e përpjekjeve të tyre dhe për të marrë reagime pas zbatimit të KPV-së (CAF). Duke u bazuar në këtë vizion, etiketa e cilësisë së KPV-së (CAF) u krijua në fund të shtatorit 2009 nga grupi ekspert për KPV-në brenda Grupit të Inovacionit të Sektorit Publik (IPSG).

Etiketa e KPV-së (CAF) konfirmon aplikimin korrekt të KPV-së. Për më tepër, do të shërbejë si konfirmim se organizata është tashmë në rrugë drejt zhvillimit të vazhdueshëm sa i përket menaxhimit të cilësisë.

Baza për procedurën e **reagimit të jashtëm profesional** të KPV-së (CAF) përbëhet nga tre pyetësorë:

1. një për procesin e vetëvlerësimit të KPV-së (CAF),
2. një për procesin e përmirësimit të KPV-së (CAF),
3. një për maturinë/pjekurinë e organizatës.

Grafiku i Procedurës për Reagime Profesionale ndaj KPV-së (CAF)

ZBATIMI I ETIKETËS SË KPV-së (CAF)		
SHTYLLA 1 PROCESI I VETË- VLERËSIMIT	SHTYLLA 2 PROCESI I VEPRIMIT PËR PËRMIRËSIM	SHTYLLA 3 PJEKURIA E MENAXHIMIT TË CILËSISË SË ORGANIZATËS

Për etiketën e KPV-së "Përdoruesi efikas i KPV-së" mund të aplikojnë organizata që:

- kanë kryer një vetë-vlerësim me KPV-në 6 deri 12 muaj më parë, dhe
- u regjistruan si përdorues të KPV-së në bazën e të dhënave evropiane dhe të RQC CAF tek (<http://caf.eipa.eu/3/98/>). Brenda faqes së internetit të RQC-së duhet të futet një formular ku organizatat mund të regjistrohen si përdorues të KPV-së (CAF). Përndryshe, ata mund të regjistrohen edhe përmes njoftimit me email në RQC dhe ruhet informacionin në një dokument në excel.

Etiketa e KPV-së "Përdoruesi efikas i KPV-së" është e vlefshme për një periudhë dy vjeçare.

Aplikimi për etiketën e KPV-së (CAF)

- ✓ Për etiketën e KPV-së mund të aplikohet në Qendrën Kërkimore për Administratën Publike KDZ. Informata të hollësishme mund të gjenden në faqen e internetit të CAF tek KDZ <http://www.caf-zentrum.at/de/CAF-Center-EU>.

Kontakt

Shkolla Rajonale e Administratës Publike (ReSPA) vepron si qendër KPV në rajon dhe ka ngritur një Qendër Rajonale të Cilësisë (RQC) për këtë qëllim. KDZ punon mbi këtë temë në bashkëpunim me Kancelarinë Federale Gjermane. Kontakti i ngushtë i RQC me KDZ-në Qendrën e Kërkimit të Administratës Publike garanton shkëmbimin e rregullt të përvojës profesionale dhe njohurive, me vendet e tjera evropiane dhe ekspertët e KPV-së.

Informacion kontakti

- ✓ **Shkolla Rajonale për Administratën Publike**
(Regional School of Public Administration) – faqja zyrtare - www.respaweb.eu
- ✓ **Qendra Rajonale e Cilësisë**
(Regional Quality Centre) – faqja zyrtare - www.respaweb.eu/caf

Skuadra e KPV-së (CAF):

Qendra Rajonale e Cilësisë

Goran Pastrovic - Tel: +382 67 179 317; E-mail: g.pastrovic@respaweb.eu

Slaven Bukarica - Tel: +382 67 179 314; E-mail: s.bukarica@respaweb.eu

Qendra Kërkimore për Administratën Publike - KDZ

Thomas Prorok - Tel: +43 1 892 349 218; E-mail: prorok@kdz.or.at

Philip Parzer - Tel: +43 1 8923492 10; E-mail: parzer@kdz.or.at